



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:001231

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04857090

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.235/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Përlaska dhe pjesëmarrjen e procesmbajtëses Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të pandehurit A. L. , i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP.nr.1/22 të datës 30.03.2022 për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.1 lidhur me par.4 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.10.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të autorizuar av.Gëzim Kollqaku dhe përfaqësuesit ligjor të dëmtuarit B. A., të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 27.10.2023 përpiloi këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri:

A. L. , i lindur me, i biri i Xh. dhe F., e vajzërisë B., në Pejë, me vendbanim në Pejë, rr.I. Q.nr.31, i identifikohet në bazë të lnj.nr. personal – lëshuar nga MPB R-Kosovës, i pa martuar, i gjendjes se mesëm ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 01.01.2022 rreth orës 01:15min në rrugën „M. T.” përkatësisht afër Entit Social në Pejë me dashje eventuale e në kundërshtim me nenin 53 par.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor shkakton aksident komunikacioni me dëme materiale dhe rrezikon jetën e këmbësorit duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe atë të dëmtuarit B.A. në atë mënyrë që i pandehuri natën kritike merr dhe drejton veturën e llojit Mercedes ngjyre e zeze me targa ZH-.... dhe gjate qarkullimit nga Semaforët e qytetit ne drejtim te Entit për pune sociale duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me kushtet dhe rrethanat e rrugës

kur vjen tek kthesa e Entit ne pamundësi te frenimit për shkak te shpejtësisë e humb kontrollin duke hyp mbi trotuar ku përveç dëmeve materiale ne veturën Sukuzi 3Z-....dhe ne lokalin e E. B., me pjesën e përparme te majte e godet këmbësorin i cili ishte duke lëvizur e te cilit i'a rrezikon jetën dhe i shkakton traumë të shumëfishtë, gjak mbledhje nën cipen e forte trunore, gjakderdhje në cipat e buta trunore, gjak mbledhje brenda ventrikulare trunore, kontusione hemoragjike mushkerore, grumbullim ajri zgavra e djathte e kraharorit, dyshim te thyerjes se unazës se dyte te qafës, thyerje e degës se poshtme te kockës pubike, thyerje e buzës se përparme te filxhanit te kofshës, te cilat lëndime janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit te forte dhe te furishëm dhe kualifikohen si dëmtime te renda trupore

- me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par 1 lidhur me par 4 të KPRK-së.

Prandaj, në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 42, 64, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kosovës.

GJYKON

- Të pandehurit A. L. i shqiptohet DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatja prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të dënuarit i shqiptohet dënimi plotësues Ndalimi i drejtimit të automjetit te të gjitha kategorive dhe atë për periudhën tre (3) vjeçare, e cila ndalesë do të zbatohet nga dita kur ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.
- Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga pala e dëmtuar.

ARSYETIM

- Historiku i çështjes, qëndrimet e palëve dhe fajësia ;

Prokuroria Themelore në Pejë pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PP.nr.1/22 të datës 30.03.2022 kundër të pandehurit A. L. shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.1 lidhur me par.4 të KPRK-së.

Gjykata e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.10.2023, në të cilën seancë prezantuan Dorjan Juniku, i pandehuri dhe mbrojtësit i tij i autorizuar av.Gëzim Kollqaku dhe përfaqësuesit ligjor i të dëmtuarit B. A., babai B. A., ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, pastaj gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit lidhur me pranimin fajësisë e si rrjedhojë në kuptim të nenit 248 par.4 të KPPRK-së, e aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë gjykata e mori mendimin e palëve në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit, ku prokurori i shtetit deklaroi “ Duke marr parasysh se ktu i akuzuri A. L. , e pranoi fajësinë Konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KKKRK--së, përkatësisht e kuptoj drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëri vullnetarisht e në mbështetje të plotë në fakte të përshtatjesh që i përmban aktakuza, ashtu që nga Gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve te procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlersoj si rrethanë lehtësuese, ndërsa në kuptim dispozitiv ligjor të nenit 70 par.2 pika 2.2 dhe pika 2.7 si rrethana rënduese të vlerësoj shkallen e lartë të dashjes eventuale e kjo për faktin se këtu i akuzuari natën kritike i vetëdijshëm se ishte duke drejtuar veturën brenda zonës urbane dhe atë me një shpejtësi të madhe e pikërisht krejtësisht në afërsi të postës në qendër të qytetit e duke qenë i vetëdijshëm mes me këto veprime mund të shkaktoj një pasojë të ndaluar me Ligj, i njëjti është pajtuar dhe dakorduar që pasoja të shkaktohet. Po ashtu kërkoj që si rrethanë rënduese të vlerësohet mosha e të dëmtuarit i cili është i moshës 22 vjeçar, gjithashtu dhe shkalla e dëmtimeve fizike të shkaktuara tek i njëjti e cili si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar traumë të shumëfishtë, gjak mbledhje në cipën e fortë trunore, gjakderdhje në cipat e buta trunore, gjakmbledhje brenda ventrit trunare trunore, kontisusione hemoraogjike mashkullore, grumbullime ajri në zgavrat e djathta të kraharorit, dyshim të thyerjes së unazës së dytë të qafës, thyerje të degës së poshtme të kokës kubike, thyerje e buzës së përparme të filgjanit të kokës, e po ashtu edhe fakti se këtu i dëmtuari edhe sot e kësaj dite ka një gjendje të rënduar psikologjike si pasojë e këtij aksidenti. Po ashtu mbesim në tërësi pranë kërkesës që përveç dënimit kryesor këtu të akuzuarit si dënim plotësues ti shqiptohet ndalimi për drejtimin e

automjetit për kategorinë B 1 dhe B, pasi janë plotësuar kushtet ligjore dhe është shkaktuar pasoja të lëndimit të rëndë trupor. Andaj nga se u tha më lartë të nderuar kërkoi që ndaj këtu të akuzuarit A. L. , të shqiptohet një dënim më i rreptë pasi që të gjithë jemi dëshmitar okular se sot rrugët në Republikën e Kosovës janë shëndruar si të ishin në vatër lufte me numër enorm të vdekurve dhe të lënduarve me lëndime të renda. Më qenë se vetëm përmes të një shqiptimi të një dënimi më të ashpër do të arrihet qëllimi i dënimit dhe risocjalizimi i të akuzuarit në faj.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit deklaroi "Më prindin e të pandehurit kemi pas kontakt të vazhdueshëm dhe është interesuar për gjendjen e djalit tim vazhdimisht, na është gjetur afër për shërimin e djalit, ka kontribuar në shpenzimet e shërim, ka qenë me mua edhe në Turqi, për nevoja të shërimit, rregullisht është interesuar, i dy familje ne nuk kemi pas e as nuk kemi asnjë problem. Unë ja kam falë për atë qka ka bo ky, gjykata e ka në dorë vendimin".

Mbrojtësi i pandehurit Avokati Gëzim Kollçaku, deklaroi " Meqenëse i mbrojturi im si në çdo fazë edhe në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në mënyrë të vullnetëshme e bëri pranimin e fajësisë, kërkojmë që ky pranim i fajësisë konform neni 70 par.3 të KPRK---së, të merret rrethanë lehtësuese ashtu siç do të merret si rrethanë lehtësuese edhe mosha e të pandehurit, pra në kohën e kryerjes së veprës penale i mbrojturi im nuk i ka pas as 19 vjet, mandej të merret parasysh edhe keqardhja e shprehur çdo herë që nga fillimi edhe në shqyrtimin e sotëm gjyqësor, kërkim falja si dhe dëshmia siç e tha edhe vetë prindi i të dëmtuarit nga momenti i parë i aksidentit prindi i të pandehurit Altin. Në çdo moment ka qenë afër të dërmuarit dhe familjarëve të tij me qëllim që sado pak ta zbus dhimbjen dhe kontriboj në shërimin sa më të shpejtë të të dëmtuarit, përveç prindi i të mbrojturit tim ka qenë me prindin e të dëmtuarit në Pejë-Prishtinë.Së bashku kanë shkuar edhe në shtetin Turk me qëllim të operacionit po ashtu edhe pas fazës post operative prapë kanë shkuar edhe për kontroll dhe siq ka potencuar prindi i të pandehurit jo një herë por dy familje janë njohur edhe më parë por tani mardhëniet i kanë më të mira se sa para ngjarjes kritike, andaj duke i marr për bazë të gjitha këto rrethana që janë posaçërisht lehtësuese i propozoj gjykatës duke u bazuar në nenin 71 dhe 72 që kemi të bëjmë me zbutjen e dënimit në kufijtë e zbutjes së dënimit ndaj të mbrojturit tim të shqiptohet një dënim minimal apo dënim i kushtëzuar me arsyetim se edhe në dënim i kushtëzuar do të ndikoj mjaftueshëm në të mbrojturin tim nga fakti se i mbrojturi im qe një vit e diçka nuk është duke ngarë automjetin dhe krejt në fund nëse më lejohet në lidhje me deklarimin e prokurorit ku thotë " si rrethanë rënduese i mori lëndimet e të dëmtuarit dhe atë i potencoj dyshimin e thyerjes së unazës së dytë, thyerjen e degës së poshtme të kaskës publike si dhe thyerjes së buzës së përparme të filxhanit të kofshës, mund të deklarohe

lirisht që sipas informatave që kam marrë për fat shumë të mirë, i dëmtuari nuk i ka këto tri lëndime e që është një përparësi shumë e madhe pse nuk i ka këto tri lëndime të cilat janë përshkruar"

I pandehuri deklaroi se “ Pajtohem në tërësi me deklarinimin e avokatit, më vjen shumë keq për çka ka ndodhur, i kërkoj falje familjes së të dëmtuarit, i kërkoj falje gjykatës dhe premtoj se nuk do ti përsëris më gabimet në të ardhmen ”.

- Vendimi ne lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 42, 64, dhe 70 të Kodit Penal të Kosovës dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si dhe duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të nxjerra nga faktet e çështjes .

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri A. L. ligjvënësi ka paraparë dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

- Përcaktimi i dënimit kryesor;

Përcaktimi i dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, qe sipas praktikës gjyqësore pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.4 të KPRK-së është dënim prej katër (4) vjetësh burgim. Pastaj, duke vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Konstatimi i rrethanave rënduese dhe lehtësuese nga gjykata;

Pas analizimit të provave të lartpërmendura dhe deklarimeve të palëve, gjykata si rrethanë rënduese gjeti intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur përkatësisht faktin se vepra penale përfshin një viktime të lënduar rëndë, si dhe faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer ne

një zone të qendrore të qytetit, e qe i pandehuri nuk ka pasur konsiderat fare për demet qe mund ti shkaktoj, te cilat edhe i ka shkaktuar.

Si rrethana lehtësuese gjykata gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe shprehjen e keqardhjes nga i pandehuri.

Gjykata ndaj të pandehurit A. L. e shqiptoj dënimin plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit të të gjitha kategorive dhe atë për periudhën 3 (tre) vjeçare, e cila ndalesë do të zbatohet nga dita kur ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Ky vendim u mor në bazë të nenit 64 par.1 dhe 2 të KPRK-së dhe atë duke e vlerësuar ndërlidhjen e këtij dënimi plotësues me dënimin kryesor dhe duke konsideruar se kjo ndalesë është e nevojshme dhe i jep mundësi të pandehurit qe brenda kësaj periudhe të sigurohet për përmirësimin e aftësive dhe rritjen e kujdesit për pjesëmarrje në komunikacion si drejtues i automjetit në të ardhmen.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, pra pala e dëmtuar nuk paraqiti kërkesë për kompensimin e dëmit siç parashihet nenin 458 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim të dëmit e as nuk e udhëzoi në kontest civil palën e dëmtuar.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjore nga neni 365 dhe 370 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJE
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
P.nr.235/22, me datë 27.10.2023

Procesmbajtësja:
Violeta Lecaj Lulaja

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.